

# AKT THEMELIMI

## "ISUFAJ KOMPANI" SH.P.K

Sot me datën 01.03.2021, unë e nënshkruara Ilirjana Mërtinaj, e bija e Ismetit dhe Shpresës, lindur në Tropojë me 02.08.1990 dhe banuese në Tiranë, shpreh vullnetin tim të lirë, të plotë e të singërtë dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", në ligjin "Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, për hartimin e këtij Akti Themelimi të shoqërisë "ISYFAJ" sh.p.k, si më poshtë vijon:

### Neni 1

#### Forma ligjore

Shoqëria "Isufaj" sh.p.k, është person juridik i së drejtës Shqiptare, **Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar** (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

### Neni 2

#### Emertimi

Emertimi i Shoqërisë është "**Isufaj Kompani**" sh.p.k.

### Neni 3

#### Themeluesi i Shoqërisë

#### Themeluesi ishoqërisë është:

Znj. **Ilirjana Mërtinaj**, shtetase shqiptare, e datëlindjes **02.08.1990**, identifikuar me pasaportë me nr. Personal: **J05802087E**, lindur në Zogaj, Tropojë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.

### Neni 4

#### Objekti

Objekti i shoqërisë është: Veprimtari e këmbimit valutor (exchange). Ushtrimi i veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jo-banke, Veprimtari e agentit për shërbimin e pagesave të ndryshme për llogari të të tretëve në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo-banke. Veprimtari të tjera të natyrës financiare të lejuara nga ligji. Agjensi turistike, rezervim dhe shitje biletash udhëtimi të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar udhëtarësh, ajror, detar dhe



tokesor si dhe shërbime të tjera për pagesa energjie, ujesjellësi, rimbushje elektronike, dërgim poste private, sigurime për automjetet etj. Konsulencë financiare, si dhe cdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj.

#### Neni 5

##### Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Mihal Grameno, "Kompleksi Mangalem 21", pallati 1, shkalla 1, kati 1, Njesia bashkia Nr. 1 dhe 2, Tiranë.

#### Neni 6

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qëndren Kombëtare të Regjistrimit.

#### Neni 7

##### Kapitali themelues

Kapitali themelues fillestar i shoqërisë është **2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë )Lekë.**

Kapitali themelues i shoqërisë "Isufaj" sh.p.k, është i ndarë në një koutë dhe vlera nominale e një kuote është **2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë )Lekë.**

Ortaku i vetëm i shoqërisë, Znj. Ilirjana Mërtinaj, është zotëuesi i të gjitha kuotave të shoqërisë, me vlerë 100% të tyre

Kontributi i ortakut është në para dhe do të paguhet në Bank, mbas regjistrimit të shoqërisë në QKR.

#### Neni 8

##### Kompetencat e Ortakut të Vetëm

Ortaku i Vetëm ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblese së Ortakëve.



Neni 9

Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori. Administrator i parë i shoqërisë "Isufaj" sh.p.k është Znj. Ilirjana Mërtinaj.

Neni 10

Shperberja dhe Likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) Me vendim te ortakut të vetem;
- b) Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- c) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë ne përputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit";
- d) Me vendim të gjykatës.

Themeluesi

Znj. Ilirjana Mërtinaj

Ilirjana Mërtinaj



**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ISUFAJ KOMPANI” SH.P.K**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 01.03.2021 (një i treti dymije e njëzet e një), unë Ilirjana Mërtinaj, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ISUFAJ KOMPANI” SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë është:

**Znj. Ilirjana Mërtinaj**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 02.08.1990, identifikuar me pasaporte me nr. Personal: J05802087E, lindur ne Zogaj, Tropojë dhe banuese ne Tiranë, madhore, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.

**Neni 2:**  
**Objekti**

Objekti i shoqërisë do të jetë, (por duke mos u kufizuar vetem në): Veprimtari e këmbimit valutor (exchange). Ushtrimi i veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jo-banke, Veprimtari e agjentit për shërbimin e pagesave të ndryshme për llogari të të tretëve në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo-banke. Veprimtari të tjera të natyrës financiare të lejuara nga ligji. Agjensi turistike, rezervim dhe shitje biletash udhëtimi të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar udhëtarësh, ajror, detar dhe tokësor si dhe shërbime të tjera për pagesa energjie, ujesjellësi, rimbushje elektronike, dërgim poste private, siguracione për automjetet etj. Konsulencë financiare, si dhe çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj.

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohe të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qëndren Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 4:**  
**Selia**

- Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rruga Mihal Grameno, "Kompleksi Mangalem 21", pallati 1, shkalla 1, kati 1, Njesia bashkia Nr. 1 dhe 2, Tiranë.**
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **isufajagency@gmail.com**

## **Kreu II Kapitali**

### **Neni 5 Kapitali themelta**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë )Lekë.  
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Ilirjana Mërtinaj**: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë** që përben **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut është në para dhe do të paguhet në Bank, mbas regjistrimit të shoqërisë ne QKR.

### **Neni 6: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit mund të bëhet vetem me vendim të ortakut të vetem, I cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 8 Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve (e cila përbëhet nga ortaku i vetem) është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve (e përbërë nga ortaku i vetem) është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara ne ligj.



Ortaku i vetem i shoqërisë është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Cdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë QKR-së për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## Neni 9

### Administrimi

Ortaku i vetem emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


(1) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(2) Personi i mëposhtëm caktohen si Administratorë i shoqërisë:

Të dhënat e identifikimit:

**Znj. Ilirjana Mërtinaj**, shtetase shqiptare, e datëlindjes **02.08.1990**, identifikuar me pasaporte me nr. Personal: **J05802087E**, lindur ne Zogaj, Tropojë dhe banuese ne Tiranë, madhore, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.

- specimenët e nënshkrimit:



## Neni 10

### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakut të vetem për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raporton përpara Ortakut të vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të therasin mbledhjen e ortakut të vetem, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse ortakut i vetem emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Ortakut i vetem mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 11

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortakut i vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të



vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakëve kontributet;
- b) i paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) i shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku i vetem ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësi ka të drejtë të ndjeki në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

#### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 12**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) me vendim të Ortakut të vetem;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

c) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Ortaku I vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaku i vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

##### **Neni 13**

##### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Ortakut të vetem, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

##### **Neni 14**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e



legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 15**

### **Mosmarrëveshjet**


Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKU I VETEM**

### **I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**\* ISUFAJ KOMPANI\***

*Ilirjana Mërtinaj*



*Emer mbiemer*

*(nenshkrimi)*

